



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 18:00

Drejtton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Lefter Koka, Zef Shtjefni, Halit Valteri, Klajdi Qama dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Tatiana Nurçe, Ilir Beqaj dhe Kujtim Gjuzi.

Të ftuar:

Besmir Beja – drejtor i Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Irena Malolli - drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Gentian Sala – kryetar i Autoritetit të Medieve Audiovizive

Jetmir Braha – drejtor i Autorizimeve në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Bleron Dokle – drejtor juridik në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Niko Peleshi – Tani kemi për diskutim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Ju kujtoj që në seancën e kaluar, para disa ditësh, e kemi miratuar në parim dhe sot kemi diskutimin dhe votimin nen për nen dhe në tërësi të këtij projektligji.

Ne jemi komision përgjegjës për këtë projektligj. Dy komisionet e tjera, Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Edukimit dhe Medies, janë komisione për dhënie mendimi.

Komisioni i Ligjeve ka depozituar një raport me disa ndryshime, ndërkohë Komisioni i Medies nuk ka bërë ndryshime. Pra, ne do t’i konsiderojmë si rekomandime mendimet e këtyre komisioneve, konkretisht, të Komisionit të Ligjeve dhe Komisionit të Medias, gjatë diskutimit dhe votimit nen për nen.

Para se të fillojmë me diskutimin nen për nen, do t’ia jap fjalën relatores, zonjës Gjermani. Më pas do të kemi diskutime dhe pyetje.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Siç e thatë edhe ju, ne pritëm mendimet dhe sugjerimet e Komisionit të Ligjeve dhe të Komisionit të Medies.

Bazuar në diskutimet që kemi bërë së bashku, që nga momenti i prezantimit të projektligjit, edhe gjatë diskutimit të projektligjit “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në diskutimet e ditës së sotme, si dhe në raportet e Komisionit të Ligjeve për këtë projektligj, propozoj të kalojmë në diskutimin nen për nen. Gjatë diskutimit nen për nen të japim edhe sugjerimet e Komisionit të Ligjeve dhe diskutimet që kemi pasur për ndryshimet e mundshme.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Dakord.

Atëherë, fillojmë me diskutimin e nenit 1.

Zonja relatore, çfarë propozimesh kemi nga komisionet për dhënie mendimi?

Eglantina Gjermani – Nuk ka ndonjë sugjerim apo ndonjë propozim konkret. Të miratohet sipas variantit të sjellë nga Këshilli i Ministrave.

Niko Peleshi – Dakord.

A ka diskutime të tjera apo komente?

E hedhim në votim.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Për sa i përket nenit 2, germa “k”, mbetet ashtu siç është. Sugjerimi që vjen edhe nga Komisioni i Ligjeve është që shkronja “k” të riformulohet si më poshtë: “Administron domenin cc.TLD.al, nëndomenet e tij, si dhe përcakton me rregullore të posaçme rregullat e hollësishme për metodologjinë, pagesat, procedurën dhe mënyrën e menaxhimit të këtij shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare”. Kjo ishte për sa i përket nenit 2, shkronja “k”, dhe...

Niko Peleshi – Edhe varianti...

Eglantina Gjermani – Ja, ta vazhdoj.

Niko Peleshi – Më fal!

Eglantina Gjermani – ...dhe të hiqet komplet germa “rr”.

Niko Peleshi – Dakord.

A ka komente dhe diskutime?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, lexojeni, nëse nuk keni pasur mundësi.

Eglantina Gjermani – Ose mund ta lexoj unë germën “r” dhe të them se kjo sugjerohet të hiqet.

Niko Peleshi – Po, ju lutem!

Eglantina Gjermani – Neni 2, germa “r”, në projektligjin e sjellë nga Këshilli i Ministrave është kështu: “Merr masat që sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike të zbatojnë detyrimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike dhe në rast lufte apo gjendjeje të jashtëzakonshme, si dhe të garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo detyrim të parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.” Edhe nga Komisioni i Ligjeve, edhe nga OSBE-ja, kjo konsiderohet si një kompetencë që nuk i takon AKEP-it.

Prandaj, propozohet të hiqet kjo kompetencë dhe neni 2 mbetet vetëm me germën “k”.

Niko Peleshi – A ka diskutime për këtë nen dhe për propozimin e Komisionit të Ligjeve?

Ta hedhim në votim si propozim, zonja relatore?

Eglantina Gjermani – Po. Pra, ngelet...

Niko Peleshi – Dakord.

Kush është dakord me riformulimin e nenit 2, siç e citoi relatorja, duke marrë parasysh rekomandimin, vërejtjen apo propozimin e Komsionit të Ligjeve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet i riformuluar neni 2, pra duke hequr germën “r”.

Neni 3.

Eglantina Gjermeni – Për nenin 3 nuk ka sugjerime apo komente specifike. Të mbetet sipas variantit të sjellë nga Këshilli i Ministrave.

Niko Peleshi – A ka diskutime dhe komente?

Kush është dakord me nenin 3, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3, sipas variantit të Këshillit të Ministrave.

Neni 4.

Eglantina Gjermeni – Për nenin 4 doja të theksoja se edhe nga sugjerimet e Komsionit të Ligjeve, edhe nga diskutimet që kemi pasur këtu në komision bashkë me përfaqësuesit e AKEP-it, sugjerojmë të riformulohet si më poshtë.

Ta lexoj direkt riformulimin apo ta lexoj si është dhe si do të riformulohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Më mirë lexo riformulimin.

Eglantina Gjermeni – Po lexoj riformulimin.

Neni 4 të riformulohet si më poshtë: “Në nenin 137, në fund të kreut V, pas pikës 19 shtohet pika 20 me këtë përmbajtje, 2/1: “Nëse ofruesit e shërbimit të komunikimeve elektronike nuk zbatojnë urdhrat/vendimet e AKEP-it, që lidhen më zbatimin e akteve/vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe të AMA-s apo të nxjerra nga çdo organ tjetër me kompetenca ligjore në këtë fushë, sipas nenit 4 të këtij ligji”. Këtu ka një gjë që nuk shkon.

Ky është ndryshimi, sepse, së pari, nenin 137, në variantin që kemi, thuhet “...në fund të kreut III”. Ne e kemi “në fund të kreut V, pas pikës 19, shtohet pika 20 me këtë përmbajtje”. Kjo ndryshon tërësisht faktin e gjobave, sepse u referohet gjobave që ka edhe AMA, duke iu bashkëngjitur nenit 137 në fund të kreut V, jo të kreut III siç është këtu.

Niko Peleshi – Të dëgjojmë një koment nga zonja Malolli.

Irena Malolli - Propozimi erdhi nga AKEP-i gjatë diskutimit në Komisionin e Ligjeve, me idenë e të qenit në parimin e proporcionalitetit për gjobat dhe mbështetet edhe nga ne, sepse referenca ishte në fund të kreut III dhe niveli i gjobave në kreun III ishte 10 herë më i lartë se te kreu V. Ndërkohë, gjoba e kreut V shkon më afër asaj që është

parashikuar te ligji për medien, me ndryshimet, sepse në këtë rast ne kemi të bëjmë me një masë, që lidhet me një shkelje të bërë kryesisht nga ofruesit e shërbimit medietik. Tek AKEP-i do të shkojë vendimi për të ekzekutuar një vendim të Këshillit të Ankesave, për të bërë bllokimin e aksesit në rastet kur është e nevojshme, sipas procedurës që ka ligji i medias, i ndryshuar.

Niko Peleshi – Për çfarë niveli gjobash bëhet fjalë? Sa është i pari dhe sa është i propozuari?

Irena Malolli - Në mos gaboj, te kreu III është në nivelin 10 milionë deri në 50 milionë lekë të rinj dhe këtu shkojmë në nivelin 1 milion dhe 5 milionë lekë të rinj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Manjola, të lutem, nëse e ke referencën e kreut III...!

Struktura e nenit 137 të ligjit për komunikimin elektronik, është e përshkallëzuar për shkeljet. 10 milionë dhe 50 milionë është te kreu III dhe këtu shkojmë në 1 milionë dhe 5 milionë. Përsëri mbetet më e lartë se ajo që është te neni 9 i ligjit nr.97, por të paktën është më poshtë.

Struktura e nenit 137 te ligji për komunikimet elektronike ka një masë gjobash, që janë shumë të rënda dhe u drejtohen operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg. Referencat janë me shkelje të neneve konkrete, që kanë të bëjnë kryesisht me masa për rregullim në rastet e shkeljes dhe veprimeve dominuese. Këto janë praktika që janë në aspektet e rregullimit të tregut të komunikimeve elektronike.

Ne e pamë me kujdes gjithë përmbajtjen e nenit 137, që ka referenca me nene përkatëse. Referenca më e saktë do të ishte nëse nuk veprohet sipas detyrimit në nenin 15, germa “e”, të ligjit “Për kushtet e autorizimit të përgjithshëm”, por duke qenë se ky propozim lidhet me ndryshime të ligjit për medien dhe me një vendim specifik të Këshillit të Ankesave, është mirë të mbetet si formulim, të paktën të jetë në një nivel më proporcional me masën e gjobës. Kjo është edhe arsyeja pse ne shkojmë në këtë propozim për ndryshim.

Niko Peleshi – Zonja relatore, si mendoni? Ta hedhim në votim propozimin që merr në konsideratë sugjerimin e Komsionit të Ligjeve apo...?

Eglantina Gjermani – Duke marrë në konsideratë edhe propozimin e Komisionit të Ligjeve, edhe argumentet që na jepen nga AKEP-i, edhe diskutimin që kemi bërë së bashku, mendoj se duhet ta votojmë.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi - Duke pasur parasysh edhe diskutimin që bëmë sot paradite, kur kaluam ligjin për medien, ne e dëgjuam edhe qëndrimin e përfaqësuesit të AKEP-it. Ishte

pikërisht insistimi i atij institucioni për të kaluar nga kreu III te kreu V. Njëkohësisht, ne sugjeruam (nuk e di nëse është marrë apo jo parasysh nga Komisioni i Medies) që edhe në kreun V niveli i gjobave të jetë më i ulët. Nuk e di nëse ky sugjerim është marrë apo jo parasysh. Kjo është diçka që u takon atyre. Gjithsesi, kalimi nga kreu III te kreu V është minimumi që mund të bëjmë për AKEP-in, duke qenë se nuk e kemi ne në dorë nivelin e gjobave, por kemi në dorë ta kalojmë AKEP-in nga kreu III në kreun V. Kështu që, edhe unë e mbështes propozimin që na ka ardhur.

Niko Peleshi – E hedhim në votim këtë riformulim, të cilin po e lexoj: “Në nenin 137 të kreut III, pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje...”. Këtu shërbimi i komisionit na sugjeron të heqim fillimin e fjalisë, pra fjalët “nëse ofruesit e shërbimeve të komunikimeve publike”, sepse është pjesë hyrëse, të cilën e ka kreu në fillim.

Po e lexoj ligjin origjinal: “...me gjobë në vlerën deri në 1 milionë lekë për shkeljet e mëposhtme të kryera nga personi juridik”. Pastaj vazhdon me 1,2,3,4,5, pra “nëse vepron në përputhje me”, “nëse vepron në përputhje me”, nëse planifikon”... Kështu që ne duhet të vazhdojmë: “...nëse nuk zbatojnë urdhrat/ vendimet e AKEP-it që lidhen me zbatimin e akteve/vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe të AMA-s apo të nxjerra nga çdo organ tjetër me kompetenca ligjore në këtë fushë, sipas nenit 4 të këtij ligji.”

Urdhëro!

Eglantina Gjermeni – Kam vetëm diçka. Kur e filluat, iu referuat nenit 4 të ligjit ekzistues. Ne do të themi në nenin 137, në fund të kreut V, jo në fund të kreut III.

Niko Peleshi - Kreu V është.

Eglantina Gjermeni – Thjesht si referencë hyrëse aty.

Niko Peleshi – Citova referencën hyrëse të kreut V.

Eglantina Gjermeni – Dakord.

Niko Peleshi – Për korrektesë në teknikën ligjore, fjalia duhet të fillojë me “nuk zbatojnë urdhrat”, ashtu siç janë edhe fjalitë e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Nuk zbatojnë”, pa “nëse”.

Kush është dakord me këtë propozim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, i Komisionit të Ligjeve, me ndryshimin që i bëmë këtu. Pra, propozimi merr në konsideratë propozimin e Komisionit të Ligjeve dhe një korrektim në formulim.

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me ndryshimin e sipërcituar.

Kalojmë te neni i fundit, neni 5: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në tërësi.

Ju falënderoj për durimin në këtë mbledhje të gjatë dhe për gjithë aktivizimin tuaj në diskutimet e dy projektligjeve të rëndësishme, që morën seriozitetin e duhur të komisionit tonë, sidomos ligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për të cilin jemi edhe komision përgjegjës!

Shumë faleminderit!

Natën e mirë!

Takohemi nesër në orën 15:30, kur do të kemi prezantimin e raportit të Komunitetit të Energjisë nga zoti Kopac.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë sallë.

MBYLLET MBLEDHJA